



Raportimi financiar dhe konsolidimi në kohën e COVID-19

Përmbajtja

- A. Rrjedhojat e përgjithshme
- B. Llojet kryesore të ndërhyrjeve shtetërore
- C. SNKSP-të përkatëse

A. Rrjedhojat e përgjithshme (1)

Sfidat afatshkurtra

- Situata e tanishme mund të kërkojë afate më të lirshme raportimi për njësitë ekonomike dhe një fokus të qartë te informacionet me rëndësi kritike për përdoruesit
- Duke pasur parasysh masat e lirshme kontrolluese përpara veprimeve, nevojiten kontrole retrospektive për të parë si janë përdorur fondet
- Duhet prituri ndikime në raportim dhe auditim, të tilla si
 - Vonesa të mundshme për shkak të mungesave në personel
 - Pasiguri dhe risk i rritur lidhur me vijueshmërinë e njësive ekonomike
 - Pasiguri se si duhen raportuar ngjarjet pas mbylljes së bilancit dhe detyrimet e kushtëzuara
- Nevojiten informacione shpjeguese shtesë në raportin për administratorët

Rrjedhojat e përgjithshme (2)

Sfidat afatgjata

- Nevojitet administrim aktiv i bilancit të qeverive duke qenë se masat kanë rritur ndjeshëm aktivet dhe detyrimet. Për rrjedhojë, është e nevojshme
 - Të fuqizohet administrimi aktiv i aktiveve (të identifikohen aktivet në tepricë, të monitorohen nevojat për zhvlerësim të aktiveve)
 - Të vendosen procese për të administruar kreditë dhe dorëzanitë (të monitorohen risqet e moskthimit të kredive dhe probabiliteti në rritje i kërkimit të dorëzanive)

Rrjedhojat e përgjithshme (3)

Sfidat afatgjata

- Financat publike pas krizës do të duhet të rimëkëmben dhe ekonomitë do të duhet të rivihen në lëvizje – publiku do të duhet të përfshihet në vendimet e vështira që duhen marrë
- Qeveritë do të kenë nevojë për një nivel rekord huamarrjeje, një pjesë e mirë e së cilës do të vijë nga tregjet e hapura. Investitorët do të duan të shohin më shumë informacione në kohë, të besueshme dhe të krahasueshme
- Llogaritë e sakta mbi të drejta dhe detyrime të konstatuara ofrojnë bazën e nevojshme
- Standardet e Kontabilitetit të Sektorit Publik të pranuar në nivel ndërkombëtar (SNKSP) ofrojnë besueshmëri

B. Llojet kryesore të ndërhyrjeve shtetërore

Ndërhyrjet ndahen në katër kategori të gjera:

1. Shpenzimet e drejtpërdrejta shtetërore

Shembuj:

- Ofrim i shërbimeve të kujdesit shëndetësor
- Kryerja e testeve
- Sigurimi i pajisjeve të mbrojtjes personale

2. Mbështetje për individët

Shembuj:

- Pagesat sociale si mbështetje me të ardhura dhe asistencë e papunësisë
- Shtyrja në kohë e tatimit mbi të ardhurat dhe lehtësimi prej tyre

3. Mbështetja për bizneset dhe për njësitë e tjera të sektorit publik

Shembuj:

- Grante, kredi, investime në kapitalin neto
- Blerje e aktiveve problematike
- Falje e detyrimit tatimor

4. Mbështetje për sistemet financiare

Shembuj

- Ulje e normave të interesit
- Blerja e obligacioneve shtetërore
- Falje e detyrimit tatimor

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (1)

1. Shpenzimet e drejtpërdrejta shtetërore

- Ndërhyrje të tilla si ofrimi i kujdesit për ata që janë prekur nga pandemia ose kryerja e analizave për COVID-19, konsiderohen si shërbime kolektive dhe individuale të ofruara për t'u dhënë përgjigje nevojave të shoqërisë në tërësi
 - Të tilla shërbime kontabilizohen në bazë të shtesave dhe ndryshimeve të bëra në **SNKSP 19 “Provigjonet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara”**, zakonisht si shpenzime në momentin e ofrimit të shërbimeve.
- Disa ndërhyrje mund të çojnë në provigjone ose në detyrime të kushtëzuara të cilat duhen njohur ose për të cilat duhen dhënë shënime shpjeguese sipas SNKSP 19.
 - Shih mbështetjen për individët dhe për bizneset, për më shumë hollësi

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (2)

2. Mbështetje për individët (1)

- Disa dërgesa për individët ose familjet, si pagesat e papunësisë apo garantimi i të ardhurave minimale, bien në objektin e **SNKSP 42 “Përfitimet sociale”**.
- Përfitime të tilla njihen si shpenzim dhe si detyrim kur
 - njësia ekonomike është tani objekt i detyrimit për një fluks dalës burimesh dhe
 - detyrimi është i matshëm
- Nëse njësia ekonomike e sektorit publik ka nevojë të ristrukturojë operacionet si pasojë e COVID-19, disa provigjone të caktuara për ristrukturimin dhe disa kosto të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës mund të bien në objektin e **SNKSP 19 “Provigjonet”**.

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (3)

2. Mbështetje për individët (2)

- Lejet shëndetësore shtesë dhe pagesat për shkurtim të vendit të punës për vetë punonjësit e njësive ekonomike të sektorit publik kontabilizohen sipas **SNKSP 39 “Përfitimet e punonjësve”**.
 - Lejet shëndetësore shtesë zakonisht njihen si shpenzim në momentin e bërjes së mungesës
 - Përfitimet nga shkurtimi i vendit të punës dhe nga ndërprerja e marrëdhënies së punës që u jepen punonjësve të veçantë njihen kur punëdhënësi nuk mund ta tërheqë më ofertën për këto përfitime

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (4)

3. Mbështetja për bizneset dhe për njësitë e tjera të sektorit publik (1)

- **SNKSP 34** “Pasqyrat financiare të veçanta”, **SNKSP 35** “Pasqyrat financiare të konsoliduara”, **SNKSP 36** “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta” dhe **SNKSP 37** “Marrëveshjet e përbashkëta” dhe **SNKSP 38** “Informacionet shpjeguese për interesat në njësitë e tjera ekonomike”, kanë lidhje me:
 - Krijimin e njësive të reja ekonomike shtetërore si pasojë e programeve të ndërhyrjes kundër COVID-19
 - Ndryshimet e mundshme të kontrollit si pasojë e disa transferimeve të caktuara të kryera nga qeveritë – shih diapozitivin në vijim për më shumë hollësi

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (5)

3. Mbështetja për bizneset dhe për njësitë e tjera të sektorit publik (2)

- Ndërhyrjet e mundshme shtetërore mund të sjellin interesa në njësi të tjera ekonomike:
 - Investimet në kapitalin neto dhe disa kredi të konvertueshme mund të sillnin marrje të kontrollit të përfituesit të financimit, çka çon në konsolidim sipas **SNKSP 35**
 - Në varësi të kushteve specifike të marrëveshjeve të financimit, nga ndërhyrjet mund të lindë kontroll i përbashkët ose influencë e konsiderueshme mbi përfituesin, çka do të kontabilizohet sipas SNKSP 36 ose SNKSP 37
 - Pavarësisht nga rezultati në kontabilizim, interesat në njësitë ekonomike të kontrolluara, marrëveshjet e përbashkëta, pjesëmarrjet ose njësitë ekonomike të strukturuar e jo të konsoliduara kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese sipas **SNKSP 38**

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (6)

3. Mbështetja për bizneset dhe për njësitë e tjera të sektorit publik (3)

- Një qeveri mund të japë dorëzani financiare për moskthim borxhi nga ana e një biznesi – këto dorëzani bien në objektin e **SNKSP 29 “Instrumentet financiare: njohja dhe matja”** dhe **SNKSP 41 “Instrumentet financiare”**
 - Sipas SNKSP 41, dorëzantë financiare njihen me vlerën e drejtë dhe më pas korrigjohen sipas një kuote të lejuar për humbjen e kredisë në kushte të caktuara
 - Sipas SNKSP 29, disa dorëzani nuk njihen, nëse nuk janë të sigurta flukset dalëse të burimeve
 - Por, këto dorëzani mund të kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese sipas **SNKSP 19** dhe probabiliteti i fluksit dalës do të duhet të monitorohet në mënyrë që të konstatohet nëse duhet bërë ose jo njohja

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (7)

3. Mbështetja për bizneset dhe për njësitë e tjera të sektorit publik (4)

- **ED 72 “Shpenzimet e transfertave”**, pas finalizimit, mund të zbatohet për disa transferime të caktuara të burimeve nga qeveritë drejt individëve ose drejt njësive ekonomike të tjera të sektorit publik
- Nga këndvështrimi i marrësit të transfertës, **SNKSP 23 “Të ardhurat nga veprimet pa këmbim vlere (tatim-taksat dhe dërgesat”** ose **ED 71 “Të ardhurat pa detyrime të performancës”**, pas finalizimit, mund të zbatohen për të hyrat nga transfertat në kuadër të ndërhyrjeve kundër COVID-19

C. SNKSP-të që mund të kenë lidhje me ndërhyrjet (8)

4. Mbështetje për sistemet financiare

- SNKSP 28 “Instrumentet financiare: paraqitja”, SNKSP 29 “Instrumentet financiare: njohja dhe matja” dhe SNKSP 30 “Instrumentet financiare: informacionet shpjeguese” dhe SNKSP 41 “Instrumentet financiare” japin udhëzime si të bëhet njohja dhe matja e zhvlerësimit të aktiveve financiare, çka mund të ndodhë si pasojë e pasigurive që lindin nga COVID-19
- Standardet e mësipërme zbatohen edhe për ristrukturimet e borxhit shtetëror dhe për kreditë me kushte të buta në kuadër të SNKSP-ve

Rezervë

SNKSP-të të tjera që mund të kenë lidhje (1)

- SNKSP 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare”
 - Në raste ekstreme, COVID-19 mund të prekë rentabilitetin e operacioneve të njësisë ekonomike – SNKSP 1 jep udhëzime për vlerësimin nëse njësia ekonomike do të ketë ose jo vijimësi të aktivitetit
 - COVID-19 mund të sjellë pasiguri lidhur me arkëtimin e llogarive të arkëtueshme nga klientët të cilët janë në vështirësi financiare – nga SNKSP 1 kërkohet dhënia e informacioneve shpjeguese mbi pasigurinë e çmuarjeve
 - Shumë programe të ndërhyrjeve kundër COVID-19 mund të konsiderohen me rëndësi materiale për shkak të rëndësisë ose të natyrës së tyre të pazakontë. SNKSP 1 kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese mbi natyrën dhe vlerën e shpenzimeve materiale.

SNKSP-të të tjera që mund të kenë lidhje (2)

- SNKSP 14 “Ngjarjet pas datës së bilancit”
 - Disa ndërhyrje të prezantuara pas datës së bilancit mund të ndikojnë ende mbi pasqyrat financiare:
 - Ndërhyrjet në nivel të konsiderueshëm mund të kenë nevojë për informacione shpjeguese shtesë me përcaktim sasior të ndikimit të çmuar në të ardhmen mbi pasqyrat financiare
 - Disa ndërhyrje ose programe mund të evidentojnë ngjarje që ekzistojnë në datën e bilancit—këto ngjarje mund të kërkojnë korrigjime në brendinë e pasqyrave financiare

SNKSP-të të tjera që mund të kenë lidhje (3)

- SNKSP 16 “Aktivet afatgjata materiale të investuara”
 - Zbatohet për vlerësimin e aktiveve afatgjata të investuara, flukset monetare të çmuara në të ardhmen të të cilave ose potenciali i shërbimit në të ardhmen i të cilave mund të jetë përkeqësuar si pasojë e pasigurive që rrjedhin nga COVID-19
- SNKSP 21 “Zhvlerësimi i aktiveve që nuk gjenerojnë të ardhura” dhe SNKSP 26 “Zhvlerësimi i aktiveve të gjenerojnë të ardhurave”
 - Masa të tilla si ruajtja e distancës sociale apo karantina mund të çojnë në përkeqësim të flukseve të çmuara ose të potencialit për shërbim të aktiveve të cilat janë mbyllur ose janë vendosur në regjim minimal
 - Një përkeqësim i tillë mund të sillte humbje nga zhvlerësimi

Udhëzime të tjera nga BSNKSP-ja të cilat mund të kenë lidhje – Udhëzimet e praktikës së rekomanduar (1)

- RPG 1 “Raportimi mbi qëndrueshmërinë afatgjatë të financave të njësisë ekonomike”
 - Ndërhyrjet kundër COVID-19 mund të kenë pasoja financiare afatgjata
 - Pasojat mund të ndikojnë në informacionet mbi qëndrueshmërinë buxhetore afatgjatë të qeverisë, përfshirë parashikimet e flukseve hyrëse dhe dalëse afatgjata
 - RPG 1 jep orientime mbi përpilimin e parashikimeve dhe informacionet shpjeguese për supozimeve mbi të cilat mbështeten

Udhëzime të tjera nga BSNKSP-ja të cilat mund të kenë lidhje – Udhëzimet e praktikës së rekomanduar (2)

- RPG 2 “Diskutimi dhe analiza e pasqyrave financiare”
 - Diskutimi dhe analiza e pasqyrave financiare mund të përdoret për të kuptuar më shumë se si pandemia e ka prekur pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të njësisë ekonomike
 - Diskutimi dhe analiza mund të shtjellojnë edhe risqet dhe pasiguritë e krijuara nga COVID-19 dhe mënyrën se si menaxhohen këto risqe dhe pasiguri

Udhëzime të tjera nga BSNKSP-ja të cilat mund të kenë lidhje – Udhëzimet e praktikës së rekomanduar (3)

- RPG 3 “Raportimi i informacioneve mbi performancën e shërbimeve”
 - Ofron kuadrin e bazuar në parime për raportimin e objektivave të shërbimit, shkallën e arritjes së këtyre objektivave dhe mënyrën se si kanë ndryshuar objektivat e realizimit të shërbimit gjatë periudhës kontabël
 - Programet e ndërhyrjes kundër COVID-19 me gjasë do të çojnë në objektiva të rinj për realizimin e shërbimeve ose do të ndryshojnë mekanizmat ekzistuese të realizimit të shërbimeve



www.ipsasb.org
